



ALBANIAN ENERGY SUPPLIER SHPK

Pasqyrat Financiare per vitin ushtrimor 2017

INDIVIDUALE

PERMBAJTJA

PASQYRA E SITUATES FINANCIARE	1
Pasqyra e te ardhurave gjithëpërfshirëse	2
PASQYRA E FLUKSIT TE MJETEVE MONETARE	3
PASQYRA E NDRYSHIMEVE NE KAPITAL	4
1. INFORMACIONE TE PERGJITHESHME	5
2. BAZA E PREGATITJES SE PASQYRAVE FINANCIARE	5
3. MJETE MONETARE	10
4. TE DREJTA TE ARKETUESHME	10
5. TE DREJTA TE TJERA TE ARKETUESHME	10
6. AKTIVE MATERIALE	11
7. TE PAGUESHME PER AKTIVITETIN E SHFRYTEZIMIT	11
8. TE PAGUESHME NDAJ PUNONJESVE	11
9. TE PAGUESHME TE TJERA	11
10. HUA TE TJERA	11
11. HUAMARRJE BANKARE AFATGJATA	11
14. TE ARDHURAT NGA AKTIVITETI KRYESOR	13
15. SHPENZIME PER MATERIAL DHE LENDE E PARE	13
16. SHPENZIMET PER PERSONELIN	13
17. SHPENZIME TE TJERA TE SHFRYTEZIMIT	13
18. TE ARDHURAT FINANCIARE	14
19. SHPENZIMI I TATIMIT MBI FITIMIN	14
20. PALET E LIDHURA	14
21. VIJIMESIA E AKTIVITETIT	14
22. ANGAZHIME DHE DETYRIME TË KUSHTËZUARA	14
23. NGJARJE PAS DATES SE BILANCIT	14

RAPORT I AUDITUESIT TË PAVARUR

Drejtuar: Ortakut të vetëm të shoqërisë “Albanian Energy Supplier” sh.p.k.
Rruga “Dervish Hima”, Pallati Ambasador 3, Kati 1, Apartamenti 3
Tiranë

Opinion

Ne kemi audituar pasqyrat financiare të shoqërisë tregtare “Albanian Energy Supplier” sh.p.k., me NIPT L42304017T të cilat përfshijnë pasqyrën e pozicionit financiar me datën 31 Dhjetor 2017, pasqyrën e të ardhurave gjithpërfshirëse, pasqyrën e ndryshimeve në kapital dhe pasqyrën e flukseve të parasë për vitin që mbyllet me këtë datë, si edhe shënimet për pasqyrat financiare, përfshirë një përmbledhje të politikave kontabël më të rëndësishme.

Sipas opinionit tonë, pasqyrat financiare bashkëlidhur paraqesin drejt, në të gjitha aspektet materiale, pozicionin financiar të Shoqërisë me datën 31 Dhjetor 2017, performancën financiare dhe flukset e parasë për vitin që mbyllet në këtë datë, në përputhje me Ligjin nr.9228 datë 29.04.2004 “Për kontabilitetin dhe pasqyrat financiare” të ndryshuar, si dhe parimet bazë e rregullat e parashikuara në Standartet Kombëtare të Kontabilitetit (SKK).

Baza për Opinionin

Ne e kryem auditimin në përputhje me Standardet Ndërkombëtare të Auditimit (SNA-të). Përgjegjësitë tona sipas këtyre standardeve janë përshkruar në mënyrë më të detajuar në seksionin e raportit në vijim, ku jepen Përgjegjësitë e Audituesit për Pasqyrat Financiare.

Ne jemi të pavarur nga Shoqëria në përputhje me kërkesat etike që janë të zbatueshme për auditimin e pasqyrave financiare në Shqipëri, dhe kemi përmbushur përgjegjësitë e tjera etike në përputhje me këto kërkesa. Ne besojmë se evidenca e auditimit që kemi siguruar është e mjaftueshme dhe e përshtatshme për të dhënë një bazë për opinionin tonë.

Përgjegjësitë e Drejtimit dhe të Personave të Ngarkuar me Qeverisjen në lidhje me Pasqyrat Financiare

Drejtimi i shoqërisë, është përgjegjës për përgatitjen dhe paraqitjen e drejtë të pasqyrave financiare në përputhje me SKK-të, dhe për ato kontrole të brendshme që drejtimi i gjykon të nevojshme për të bërë të mundur përgatitjen e pasqyrave financiare që nuk përmbajnë anomali materiale, qoftë për shkak të mashtrimit apo gabimit.

Në përgatitjen e pasqyrave financiare, drejtimi është përgjegjës për të vlerësuar aftësinë e Shoqërisë për të vazhduar në vijimësi, duke dhënë informacion, nëse është e zbatueshme, për çështjet që kanë të bëjnë me vijimësinë dhe duke përdorur parimin kontabël të vijimësisë përveç se në rastin kur drejtimi synon ta likujdojë Shoqërinë ose të ndërpresë aktivitetet, ose nëse nuk ka alternativë tjetër reale përveç sa më sipër.

Ata që janë të ngarkuar me qeverisjen, janë përgjegjës për mbikëqyrjen e procesit të raportimit financiar të Shoqërisë.

Përgjegjësitë e Audituesit për Auditimin e Pasqyrave Financiare

Objektivat tona janë që të arrijmë një siguri të arsyeshme lidhur me faktin nëse pasqyrat financiare në tërësi nuk kanë anomali materiale, për shkak të mashtrimit apo gabimit, dhe të lëshojmë një raport auditimi që përfshin opinionin tonë. Siguria e arsyeshme është një siguri e nivelit të lartë, por nuk është një garanci që një auditim i kryer sipas SNA-ve do të identifikojë gjithmonë një anomali materiale kur ajo ekziston.

Anomalitë mund të vijnë si rezultat i gabimit ose i mashtrimit dhe konsiderohen materiale nëse, individualisht ose të marra së bashku, pritet që në mënyrë të arsyeshme të influencojnë vendimet ekonomike të përdoruesve, të bazuara në këto pasqyra financiare.

Si pjesë e auditimit në përputhje me SNA-të, ne ushtrojmë gjykim profesional dhe ruajmë skepticizmin profesional gjatë gjithë procesit të auditimit. Ne gjithashtu:

- Identifikojmë dhe vlerësojmë rreziqet e anomalisë materiale, qoftë për shkak të mashtrimit ose gabimit, hartojmë dhe kryejmë procedurat e auditimit në përgjigje të këtyre rreziqeve, dhe marrim evidencë auditimi që është e mjaftueshme dhe e përshtatshme për të siguruar një bazë për opinionin tonë. Rreziku i mosbulimit të një anomalie materiale si rezultat i mashtrimit është më i lartë se rreziku si rezultat i gabimit, sepse mashtrimi mund të përfshijë marrëveshje të fshehta, falsifikime, përjashtime të qëllimshme, informacione të deformuara, anashkalime të kontroleve të brendshme.
- Sigurojmë një njohje të kontrollit të brendshëm që ka të bëjë me auditimin, me qëllim që të përcaktojmë procedurat e auditimit që janë të përshtatshme sipas rrethanave përkatëse të shoqërisë, por jo për qëllime të shprehjes së një opinionimi mbi efikasitetin e kontrollit të brendshëm të Shoqërisë.
- Vlerësojmë përshtatshmërinë e politikave kontabël të përdorura dhe arsyeshmërinë e çmuarjeve kontabël dhe të shpjegimeve përkatëse të bëra nga drejtimi.
- Nxjerrim një konkluzion në lidhje me përshtatshmërinë e përdorimit të bazës kontabël të vijimësisë, dhe bazuar në evidencën e auditimit të marrë, nëse ka një pasiguri materiale në lidhje me ngjarjet ose kushtet, e cila mund të hedhë dyshime të mëdha mbi aftësinë e shoqërisë për të vijuar veprimtarinë. Nëse ne arrijmë në përfundimin që ka një pasiguri, ne duhet të tërheqim vëmendjen në raportin e audituesit në lidhje me shpjegimet e dhëna në pasqyrat financiare, ose nëse këto shpjegime janë të papërshtatshme, duhet të modifikojmë opinionin tonë. Konkluzionet tona bazohen në evidencën e auditimit të marrë deri në datën e raportit të auditimit. Megjithatë, ngjarje ose kushte të ardhshme mund të bëjnë që Shoqëria të ndërpresë veprimtarinë.

Ne komunikojmë me Drejtimin, përveç të tjerave, lidhur me qëllimin dhe kohën e auditimit dhe gjetjet e rëndësishme të auditimit, përfshirë ndonjë mangësi të rëndësishme në kontrollin e brendshëm, që ne mund të identifikojmë gjatë auditimit.

Venis-Audit & Financë sh.p.k.
Vera Lala
Administrator

Tiranë, 30 Mars 2018



Vera Lala
Auditues Ligjor

ALBANIAN ENERGY SUPPLIER
SHENIMET E PASQYRAVE FINANCIARE
VITI 2017

(Vlerat ne ALL)

PASQYRA E SITUATES FINANCIARE

	Shenime	31-Dec-17	31-Dec-16
AKTIVET			
Aktive afatshkurtra			
Mjete monetare	3	35,985,663	1,010,332
Te drejta te arketueshme	4	16,713,357	-
Te drejta te tjera te arketueshme	5	56,716,846	102,658,506
Te arketueshme nga njesite ekonomike brenda grupit		-	-
Totali i aktiveve afatshkurtra		109,415,867	103,668,838
Aktive afatgjate			
Aktive afatgjata materiale	6	319,738,961	3,123,385
Aksione dhe pjesmarrje te tjera ne njesi te kontrolluara	6	-	-
Parapagime dhe te tjera		-	-
Totali i aktiveve afatgjata		319,738,961	3,123,385
TOTALI I AKTIVEVE		429,154,827	106,792,223
DETYRIMET DHE KAPITALI			
Detyrime afatshkurtra			
Te pagueshme per aktivitetin e shfrytezimit	7	124,961,569	3,952,875
Te pagueshme ndaj punonjesve dhe sigurimeve shoqerore/shendetesore	8	575,827	738,270
Te pagueshme per detyrime tatimore	9	-	-
Te pagueshme te tjera	10	438,719	-
Hua te tjera	11	17,600,139	1,431,517
Totali i detyrimeve afatshkurtra		143,576,254	6,122,662
Detyrime afatgjata			
Titujt e huamarrjes		-	-
Huamarrje te tjera afatgjata	12	188,934,878	-
Totali i detyrimeve afatgjata		188,934,878	-
Detyrime totale		332,511,132	6,122,662
Kapitali dhe rezervat			
Kapitali Aksioner	13	101,302,600	101,302,600
Fitimet e pashperndara		(633,038)	(1,080,031)
Fitimi i vitit		(4,025,866)	446,993
Totali i kapitalit		96,643,695	100,669,562
TOTALI I DETYRIMEVE DHE KAPITALIT		429,154,827	106,792,223

Pasqyra e pozicionit financiar duhet lexuar se bashku me shenimet shpjeguese ne faqet 6 deri 15 qe jane pjese perberese e pasqyrave financiare.

ALBANIAN ENERGY SUPPLIER
SHENIMET E PASQYRAVE FINANCIARE
VITI 2017

(Vlerat ne ALL)

PASQYRA E TE ARDHURAVE GJITHEPERSHIRESE

	Shenime	31-Dec-17	31-Dec-16
Te ardhurat nga aktiviteti kryesor	14	253,981,996	-
Shpenzime per material dhe lende e pare	15	(249,107,696)	-
Shpenzime te personelit	16	(1,631,297)	(366,120)
Shpenzime te tjera shfrytezimi	17	(6,393,910)	(303,735)
Shpenzime amortizimi	6	(13,787)	-
Fitim/humbje nga kurset e kembimit	18	(867,718)	1,116,848
Te ardhura nga investime te tjera financiare afatgjata	0	-	-
Te ardhura te tjera financiare	18	1,546	-
Fitimi para tatimit		(4,025,866)	446,993
Tatimi mbi fitimin	19	-	-
Fitimi i vitit		(4,025,866)	446,993
Te ardhura te tjera gjithepershireshe per vitin		-	-
Totali i te ardhurave gjithepershireshe per vitin		(4,025,866)	446,993

Elisabeta Hajrullaj
Pergatiti:
Elisabeta HAJRULLAJ
Drejtore e finances

Florian Lame
Miratoi:
Florian LAME
Administrator



ALBANIAN ENERGY SUPPLIER
SHENIMET E PASQYRAVE FINANCIARE
VITI 2017

(Vlerat ne ALL)

PASQYRA E FLUKSIT TE MJETEVE MONETARE¹

	31-Dec-17	31-Dec-16
Fluksi i parasë nga aktivitetet operative		
Humbja para tatimit	(4,025,866)	446,993
<i>Sistemime për:</i>		
Zhvlerësimin dhe amortizimin	13,787	-
Tatimi fitimi	-	-
Humbja operative përpara ndryshimeve në kapitalin punues	(4,012,079)	446,993
<i>Ndryshimet në aktivet dhe detyrimet operative:</i>		
Rritje ne te drejta te arketueshme	29,228,302	(102,567,373)
Rritje ne te arketueshme nga njesite ekonomike brenda grupit	-	-
Rritje/(Renie) ne parapagime	-	-
Rritja/(zvogelimi) I te pagueshme per aktivitetin e shfrytezimit	121,008,694	3,808,427
Rritja/(zvogelimi) I te pagueshme ndaj punonjesve dhe sigurimeve shoqerore/shendetsores	(162,443)	353,880
Rritja/(zvogelimi) I te pagueshme per detyrime tatimore	-	-
Rritja/(zvogelimi) I te pagueshme te tjera	438,719	-
Fluksi neto i parasë i gjeneruar/(përdorur) në aktivitetet operative	146,501,193	(97,958,073)
Fluksi neto i parasë i përdorur nga aktivitetet investuese	(316,629,363)	(3,081,718)
Blerja e kompanise se kontrolluar x se kontrolluar minus parate e arketuara	-	-
Blerje e aktiveve afatgjata materiale	(316,629,363)	(3,081,718)
Blerje e aktiveve afatgjata jomateriale	-	-
Fluksi i parasë nga aktivitetet financuese		
Hyrje nga emetimi i kapitalit aksionar	-	101,302,500
Te ardhura nga huamarrja	205,103,50	-
Divident	-	-
Rritja e kapitalit	-	-
Fluksi neto i parasë i përdorur nga aktivitetet investuese financuese	205,103,501	101,302,500
Rritje/(renie) neto në mjete monetare dhe ekuivalentë	34,975,330	262,709
Mjete monetare dhe ekuivalentë në fillim të vitit	1,010,332	747,624
Mjete monetare dhe ekuivalentë në fund të vitit	35,985,663	1,010,332

¹ Pasqyra e Flukseve të Mjeteve Monetare është përgatitur sipas metodës indirekte.

**ALBANIAN ENERGY SUPPLIER
SHENIMET E PASQYRAVE FINANCIARE
VITI 2017**

(Vlerat ne ALL)

PASQYRA E NDRYSHIMEVE NE KAPITAL

	Kapitali i nenshkruar	Rezerva ligjore	Fitimet e pashperndara	Fitimi i vitit	Totali i kapitalit
Pozicioni financiar ne 01 Janar 2016	101,302,600	-	(1,080,031)	-	100,222,569
Te ardhurat totale gjithepershirse te vitit:					
Fitim i vitit	-	-	446,993	-	446,993
Te ardhura te tjera gjithepershirse	-	-	-	-	-
Totali i te ardhurave gjithepershirse per vitin	101,302,600	-	(633,038)	-	100,669,562
Transaksione me pronaret e njesisë ekonomike te njohura direkt ne kapital:					
Dividende te deklaruar	-	-	-	-	-
Totali i transaksioneve per pronaret e njesisë ekonomike	-	-	-	-	-
Pozicioni financiar ne 31 Dhjetor 2016	101,302,600	-	(633,038)	-	100,669,562
Te ardhurat totale gjithepershirse te vitit:					
Fitim i vitit	-	-	-	(4,025,866)	(4,025,866)
Te ardhura te tjera gjithepershirse	-	-	-	-	-
Totali i te ardhurave gjithepershirse per vitin	-	-	-	(4,025,866)	(4,025,866)
Transaksione me pronaret e njesisë ekonomike te njohura direkt ne kapital:					
Dividende te deklaruar	-	-	-	-	-
Rritja e Rezerves se kapitalit	-	-	-	-	-
Emetimi I aksioneve	-	-	-	-	-
Totali i transaksioneve per pronaret e njesisë ekonomike	-	-	-	-	-
Pozicioni financiar ne 31 Dhjetor 2017	101,302,600	-	(633,038)	(4,025,866)	96,643,695